



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 491/14Prot.

Tiranë, më, 30/11/2017

V E N D I M

Nr. 162, Datë 30/11/2017

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË SHKODËR DHE 10-ISH KOMUNAT: SHALË, PULT, SHOSH, POSTRIBË, RRETHINA, GURI ZI, BËRDICË, ANA E MALIT, DAJÇ DHE VELIPOJË ME OBJEKT "VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË MBI SHKALLËN E ZBATIMIT NGA SUBJKETI TË LIGJEVE RREGULLOREVE DHE POLITIKAVE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt: "*Vlerësimi i përputhshmërisë mbi shkallën e zbatimit nga subjekti të ligjeve rregulloreve dhe politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve*", të ushtruar në Bashkinë Shkodër për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2016 dhe 10 ish-Komunat Shalë, Pult, Shosh, Postribë, Rrethina, Gur i Zi, Bërdicë, Ana Malit, Dajç dhe Velipojë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse (vendimet ekzekutive), si edhe **nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim sistemimin, likuidimin e vlerave në shumën **265,872,795 lekë**, veçanërisht arkëtimin e të ardhurave të munguara nga taksat vendore në vlerën **216,201,795 lekë** (*1,383,000 lekë nga rekomandimet e mëparshme, 216,201,795 lekë nga taksat, 3,300,000 lekë nga lejet e ndërtimit dhe shfrytëzimit dhe 44,988,000 lekë gjopa e kamatëvonesa*), si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër për periudhën 2014-2016 lidhur me hapat për instalimin, zbatimin e kërkesave për Sistemin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, ka mangësi në hartimin e mbajtjen, dokumentimin, raportimin e veprimeve dhe masave për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsisve, lidhur me “Regjistrin e Riskut”, në identifikimin e menaxhimin e risqeve me ndikim të lartë në fushën e menaxhimit të aseteve, *identifikimin e statusit të gjendjes juridike, marrjen e vënien nën administrim dhe në efikasitet të aseteve pronë e bashkisë, identifikimin e aseteve në territor e juridiksion (toka, troje, terrene ndërtesa, infrastrukturë urbane nën e mbi tokë, aseteve të llojit pyje e toke bujqësore, ujëra vepra ujore, florë, faunë etj); gjendje kjo çka është në mos përmbushje të Kreut të III, nenet 19-22 të nr. 10296, datë 8.7.2010.*

Në disa raste për çështje me risk të lartë ka vlerësim jo të drejtë të risqeve dhe fushave me risk për realizimin e objektivave, si në fushat që mbulohen nga Drejtoria e Urbanistikes, Drejtoria e te ardhurave, Drejtoria Juridike dhe e Aseteve dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Në plotësimin e dokumentit “Pyetësor i Vetëvlerësimit” ka mangësi të lidhura me vlerësimin maksimal të dy komponentëve të rëndësishëm, si “mjedisi i kontrollit” dhe “aktivitetet e kontrollit”, vlerësime të cilat bien ndesh me realitetin dhe me mangësitë që janë konstatuar edhe gjatë kryerjes së auditimit në Bashkinë Shkodër (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 8-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: Bashkia Shkodër, përkatësisht Drejtoria Juridike e Aseteve, Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, Drejtoria e Shërbimeve Publike Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve Ujërave, të marrin masat në përmirësimin, hartimin ndjekjen e kërkesave të Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; hartimin e ndjekjen e sakte të “Regjistrin te Riskut”; identifikimin, evidentimin menaxhimin e risqeve, me ndikim të lartë në menaxhimin e aseteve; *identifikimin e statusit të gjendjes juridike, marrjen dhe vënien nën administrim dhe në efikasitet të aseteve;* dokumentimin e hapave të realizimit të regjistrin të riskut, i cili të shoqërohet me raportim për veprimet e kryera masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsisve; vlerësimin e kategorizimin e saktë të risqeve në fushën e Urbanistikes dhe fushën e të ardhurave nga taksat, si dhe në plotësimin me saktësi dhe vërtetësi të dokumentit “Pyetësor i Vetëvlerësimit” të gjithë komponentëve përkatës, sidomos dy komponentëve të rëndësishëm, “mjedisi i kontrollit” dhe “aktivitetet e kontrollit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i debitorëve rezulton se llogaria sintetike “Kërkesë arkëtimi mbi debitorët” në fund të vitit 2014 paraqitet me gjendje në vlerën 166,616,512 lekë dhe në fund të vitit 2015 gjendja arrin në vlerën 439,895,787 lekë, ndërsa në fund të vitit 2016 kjo gjendje arrin në vlerën 620,847,272 lekë ose me rritje në vlerën 180,951,485 lekë, ku vlerën kryesore e ka llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila në fund të vitit 2014

paraqitet në vlerën 122,198,613 lekë dhe në fund të vitit 2015 gjendja arrin në vlerën 385,137,518, lekë. Në fund të vitit 2016 gjendja e llogarisë “Debitorë të ndryshëm” arrin në vlerën **559,798,501 lekë** pra me një rritje në vlerën **174,660,983 lekë** (Trajtuar hollësisht ne faqen nr. 34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa të hartojë program të veçantë pune duke përcaktuar detyra konkrete me afate për secilën strukturë në drejtim të arkëtimit të vlerave të detyrimeve debitore përcaktuar sipas viteve 2014, 2015 dhe 2016, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” (detyrimet ndaj të tretëve) rezulton se gjendja me datë 30.09.2016 është në vlerën 188,215,385 lekë, dhe në datë 30.09.2017 gjendja rezulton 82,027,253 lekë, pra gjatë periudhës 1 vjeçare janë likuiduar 100,188,132 lekë. (Trajtuar hollësisht ne faqen nr. 44-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren të gjitha masat organizative për të likuiduar shumën ndaj kreditorëve në vlerën prej **82,027,253 lekë, detyrime të prapambetura sipas gjendjes pasqyruar datë 30.09.2017.**

Për këtë Kryetari i Bashkisë Shkodër të hartojë një plan për daljen nga situata e vështirë financiare dhe ta dërgojë për miratim në Këshillin Bashkiak propozimin, bazuar në disa nga alternativat e mundshme:

a) Bashkia me burimet e veta në dispozicion, të marrë masat për të risjellë situatën e pagesave në normalitet brenda një afati të përcaktuar nga Këshilli Bashkiak.

b) Të mundësojë rishikimin e buxhetit për të adresuar problemin duke ndryshuar zërat e shpenzimeve;

c) Të mundësojë negocimin me kreditorët për të ristrukturuar pagesat për detyrimet e konstatuara dhe të palikuiduara.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër për periudhën 2014-2016, lidhur me vlerësimin, funksionimin dhe efencën e strukturës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm u konstatua pamjaftueshmëri në kapacitetet audituese të nevojshme për përballimin me auditime sipas fushave, performancë e pamjaftueshme shprehur në mosrealizimin e numrit të auditimeve (realizimi i planeve vjetore në nivelet 62-67 %), mosndjekje e realizimit të rekomandimeve për auditimet e kryera në vitet 2014, 2015, 2016, si dhe tematikë e kufizuar në llojet e auditimit dhe lënien mënjanë të auditimeve të përputhshmërisë kryesisht të fushës së aseteve. Konstatohet mungesë e auditimeve të kombinuara me përfshirjen në grupe auditimi të specialistëve të fushave të rëndësishme si bujqësi, pyje ujëra, kullota, territor-urbanistikë pasuri e resurse etj, të diktuar nga rritja e numrit të pasurive prej Reformës Territoriale. Kjo gjendje bie në papajftueshmëri me ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm ne sektorin publik” VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësisve të auditimit të Brendshëm ne Sektorin Publik” dhe me legjislacionin e mëparshëm (Trajtuar hollësisht ne faqet nr. 11-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, të marrë masat të analizojë, plotësojë dhe përshtasë kapacitetet audituese me ndryshimet e ndodhura pas Reformës Territoriale e cila ka sjellë transferimin e aktiviteteve, veprimtari të reja, shtim të funksioneve, në mënyrë që të sigurohet rritja e shkallës së efencës dhe efektivitetit të Auditimit të Brendshëm në funksion të përmbushjes së misionit të tij.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër nuk rezultojnë të dokumentuara dhe administruara në cilësinë e letrave me vlerë blloqet e gjobave të IMTV, gjobat e urbanistikës, gjobat e tatimorëve, gjobat e inspektorëve veterinerë, sikundër administrohen letrat me vlerë, pulla takse të gjendjes civile, pulla takse gjykate dhe fletë gjoba të policisë bashkiake; gjendje

kjo në kundërshtim me VKM nr. 1497, datë 19.11.2009 “Për shtypjen e letrave me vlerë” i ndryshuar, pika 2 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës dhe Drejtoritë e Strukturat përkatëse të marrin masa të dokumentojnë dhe administrojnë si letra me vlerë edhe blloqet e gjobave të IMTV, gjobat e urbanistikës, gjobat e tatimorëve dhe gjobat e inspektorëve veterinerë sipas VKM përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në hartimin e preventivave të shërbimit të pastrimit dhe mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbërta dhe lidhjen e kontratave themelore datë 24.01.2013, me afat 5 vjeçar dhe aneks kontratave, nuk ka parashikuar saktë zërat e punës duke llogaritur gabim pagesat për punë të kryer në ditët me shi, etj, ka përcaktim jo të sakta të zërave “menaxhim dhe mirëmbajtje kazanësh në sasinë 50- 60 copë”, “mirëmbajtje 30% e rrugëve në sipërfaqen prej 3,410 km” dhe në zërin “fshirje mekanike”, “fshirje manuale”, në zërin “prodhim fidanë lule sezonale në sipërfaqen prej 500 m²”, “mirëmbajtje lulishte me gjithë elementët”, elementë këto të kontratës së gjelbërimit (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve publike në lidhjen e kontratave për vitin 2018, të bëjë rishikimin e preventivave pjesë e kontratave të shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit duke reflektuar në to gjithë elementët, përfshirë kushtet atmosferike, argumentimin e zërave cilësuar më sipër, me synim rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe rritjen e efektivitetit të shpenzimeve për këto shërbime.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër dhe në ish Komunat nuk është mbajtur në rregull protokollin i mbledhjeve të Këshillit duke mos evidentuar saktësisht prezencën e këshilltarëve ndërkohë që listë prezencë për pagesat e ish këshilltarëve është nënshkruar rregullisht në çdo muaj nga sekretari dhe Kryetari i Këshillit pa mungesa duke u paguar në mënyrë jo mirë të dokumentuar vlera prej **9,255,291 lekë**. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 37 pika 2 germa “a” dhe nenin 29 e 31 të ligjit nr.8652 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 24-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashki, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve. Pas verifikimit dhe saktësisht të këtyre pagesave, **i lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët.

Detyrimi për mos llogaritjen e tatimit mbi pagë duhet të paguhet, pasi rrjedh nga kërkesat e kreut II-të, neni 8 “E ardhur e tatueshme” shkronja “g”, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015 është kryer inventarizimi fizik dhe sipas inventarit datë 31.12.2015 dhe relacionit datë 28.02.2016, nuk kanë rezultuar diferenca, por kanë rezultuar materiale jashtë përdorimit në vlerën **15,919,939 lekë** të detajuara sipas njësive administrative, zyrove përkatëse, klasifikimit ekonomik, llogarive respektive me analiza përkatëse (dokumentuar me fletë hyrjet nr.152, datë 29.12.2016 dhe nr.30, datë 29.04.2016). Mbajtja në magazinë e materialeve të vlerësuara për jashtë përdorimit në vitin **2015**, mos asgjësimi i tyre dhe sistemimi në kontabilitet, janë veprime në pa pajtueshmëri me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, kreun IV pika 109, neni 73 deri

në nenin 106, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 (Trajtuar hollësisht në faqen nr. 36-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër me ish Komunat (Njësitë Administrative) të marrë masat për vazhdimin e procedurave ligjore, ngritjen e komisionit të asgjësimit të vlerave materiale të vlerësuara për jashtë përdorimit në fund të vitit 2015. Të analizohet niveli i lartë i vlerave të nxjerra jashtë përdorimit dhe të dalë përgjegjësia individuale dhe institucionale rast pas rasti.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër dhe ish Komunat (Njësitë Administrative) para dhe pas reformës territoriale konstatohen detyrime debitorë nga mos mbledhja e të ardhurave nga taksat vendore për periudhën e audituar në vlerën **216,201,795 lekë** situatë që ka ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë.

Me gjithë punën e bërë nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore të Bashkisë Shkodër, detyrimet e pa likuiduara në vlerën **109,928,429 lekë** (2545 subjekte) i përkasin Bashkisë përpara përfshirjes së ish-komunave, dhe me përfshirjen e detyrimeve të ish-komunave për **1116 subjekte** në vlerën **106,273,366 lekë**, pas reformës detyrimi në total arrin në vlerën **216,201,795 lekë** për **3661 subjekte** biznesi. Sipas historikut të krijimit të këtyre detyrimeve rezultojnë:

- të trashëguara nga viti **2014** janë 589 subjekte debitorë në vlerën 40,284,353 lekë,
- për vitin **2015** janë 1,648 subjekte debitorë në vlerën 121,893,568 lekë,
- për vitin **2016** janë 1,424 subjekte debitorë në vlerën 54,023,874 lekë (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 99-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga 3,661 subjektet e biznesit në vlerën **216,201,795 lekë**. Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimit tatimor për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

a. Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c. Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në RSH” të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

d. Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 181, të ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës Shqipërisë” i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative (llogaritjen e kamat vonesave) të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e të ardhurave vendore, të evidentojë dhe njoftojë familjarët për të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, etj., në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”. Të hartohet regjistri i taksapaguesve familjar.

d. Nga Drejtoria e të ardhurave vendore, Bashkia Shkodër të listohen në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës **nga fermerë**, taksa e popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor **edhe në median lokale** të Bashkisë Shkodër për të paguar detyrimin tatimor. Njoftim vlerësimi t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, ndërtesës dhe tarifën të tjera të pa paguara.

e. Zyra e taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryej rakordim me të gjitha subjektet që zhvillojnë aktivitet minerar në territorin e saj, për përcaktimin e saktë të detyrimeve të pa paguara që kanë ndaj bashkisë, si edhe ndaj ish komunave, lidhur me taksat dhe tarifatat vendore. Pas këtij rakordimi të hartoj listën përfundimtare të debitorëve për këto subjekte dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Pas reformës administrative territoriale për vitin 2015 për taksën mbi tokën bujqësore nuk është bërë planifikim real i studiuar dhe mbështetur në të dhënat dhe në sipërfaqen në ha që dispononin ish-komunat. Për vitin 2016 është bërë planifikimi bazuar në kapacitetet e plota sipas të dhënave që disponojnë Njësitë Administrative. Plani është konfirmuar nga Administratorët e Njësisë Administrative, por nuk ka qenë i konfirmuar zyrtarisht nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-ve, kështu që nuk ka evidencë të saktë mbi gjendjen e tokës bujqësore, regjistrin për secilën familje, pranë Drejtorisë së të ardhurave vendore. Gjithashtu nuk janë krijuar regjistrat e plotë mbi evidentimin e taksës mbi tokën bujqësore dhe taksës për ndërtesën, nuk janë marrë të dhënat e nevojshme nga Njësitë Administrative (ish komuna) dhe nga ZVRPP Shkodër për pronësinë mbi tokën bujqësore dhe ndërtesës (*Trajtuar hollësisht në faqen nr. 100-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të ngrëjë komision me specialistë të fushës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës së Qarkut Shkodër (DAMT), për azhurnimin e sipërfaqeve të tokës, pajisjen me AMTP të familjeve, në Njësitë Administrative dhe regjistrimin e tyre pranë ZVRPP Shkodër, sipas kërkesave të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi" si dhe të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm mbi transferimin e zërave kadastral, dëmtimin e tokave, klasifikimin dhe kategorizimin e tokave dhe plotësimin e regjistrave të tokave, me synim parashikimin real dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore. Gjithashtu të marrë masat për përfundimin e regjistrave të evidentimit të sipërfaqeve dhe detyrimeve të pa shlyera nga subjektet e biznesit dhe familjarët për taksën e tokës bujqësore dhe taksën e ndërtesës duke ndjekur të gjitha hapat ligjor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga Autoriteti Kontraktor (*Bashkia Shkodër*) nuk është përgatitur e hartuar asnjë raport i hollësishëm në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e realizimit të suksesshëm të kontratave, njëkohësisht në të gjitha kontratat e përpiluara e miratuara të lidhura me operatorët ofertat e të cilëve janë shpallur fituese, nuk është përcaktuar personi, ose struktura organizative përgjegjës në emër të palës për të ndjek realizimin dhe përfundimin e kontratës, veprim në mospërputhje me Kreu IX "*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*", neni 77 "*Mbikëqyrja e kontratës*" pikat (3), (4) të parashikuar në çdo kontratë neni përkatës "*Përfaqësimi palëve*" (*Trajtuar më hollësisht në faqe 47-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor nëpërmjet Njësisë Prokurimit të marrë masa të plota për të gjitha kontratat e lidhura në përfundim të afatit të hartojë raport të hollësishëm për korrektësinë dhe cilësinë e realizimit të suksesshëm të saj, nëpërmjet personit, apo strukturës organizative përgjegjës.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në 11 investimet e audituara në Bashkinë Shkodër, "*Blloku i pallateve Vau i Dejës*", "*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i III-të*", "*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i IV-të*", "*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2013*", "*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2014*", "*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2015*", "*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2016*", "*Zbatim rikualifikim Urban Blloque Banimi Qemal Draçini (pallati me Hark)*", "*Rikualifikim urban i ambienteve të jashtme të*

Katedrales së Shën Shtjefnit”, “*Sistemim blloqe banimi Bulevardi Mehmet Pashe Plaku (pallate parafabrikat)*” dhe “*Rikonstruksion linja e ndriçimit rruga Gjovalin Gjadri*” me vlerë totale të kontratave 98,323,968 lekë pa t.v.sh nga verifikimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në katër prej tyre në vlerën 9,249,365 lekë pa t.v.sh si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, pika 9 dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “*Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*”, pika 4, paragrafi 4 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73 -99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër, të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, pika, 4 paragrafi 4.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër, Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) me tre Dokumentet përbërës, është në vazhdim të procedurës së miratimit nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak dhe dërgimi e marrjen e miratimit në Këshillin Kombëtar të Territorit (KKT). *Referuar strukturës së projektit të PPV përbërë nga 3 komponentë konstatojmë se nuk reflektohen qartësisht elementet si: a.* analiza e konsoliduar e cila përfshinë pikat e forta dhe mundësitë, pikat e dobëta dhe kërcënimet; *b.* Matrica e Qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të planit; *c.* Matrica e zbatimit të planit; *d.* Matrica e prioritarizimit të projekteve; dhe *e.* Fishat e projekteve) të gjitha këto shoqëruar me shpërndarjen e buxheteve të nevojshëm apo *burimet e financimit të mbuluar nga buxheti i Bashkisë dhe buxheti Qendror, me synim që ky të jetë sa më funksional i aplikushëm dhe lehtësisht i përdorshëm nga personeli zbatues gjatë shtrirjes në kohën prej 25 vjetësh te parashikuar por edhe lehtësisht i monitorueshëm, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, ligjin nr.10296, datë 10.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” (Trajtuar hollësisht ne faqet 108-109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Kryetari dhe Këshilli Bashkiak të marrin masa, të vazhdojnë procedurat deri në miratim dhe njëkohësisht me grup të veçantë të shqyrtojnë plotësinë, saktësinë dhe funksionalitetin e *strukturës së projektit të PPV përbërë nga 3 komponente ku të reflektohen qartësisht elementet trajtuar më sipër; të gjitha këto të shoqëruara me shpërndarjen e buxheteve të nevojshëm apo burimet e financimit të mbuluar nga buxheti i Bashkisë, dhe buxheti Qendror, me synim që Projekti PPV të jetë sa më funksional i aplikushëm dhe lehtësisht i përdorshëm dhe i monitorueshëm nga personeli zbatues në shtrirjen kohore te parashikuar 25 vjet.*

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër, nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit përbërës të dosjeve të lejeve të ndërtimit (Lejeve zhvillimore) u konstatuan mangësi dhe shkelje në drejtim të kontrollit të zbatimit të lejeve të ndërtimit lidhur me ecurinë e fazave të

procesit të punimeve dhe afatet. Konstatuam se **14 leje ndërtimi** prej 131 lejeve gjithsej, kanë sjellë si pasojë të ardhura të munguara në vlerën **1,400,000 lekë** nga mungesa e kontrollit përfundimtar dhe nga mos kontrolli në kohë i fazave, në referencë të nenit 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", nenit 52, pika 3 të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar dhe duke rezultuar me deviacione në afatet dhe grafikët përcaktuar në lejet përkatëse të ndërtimit, pasqyruar në tabelën emërtuar: "Të ardhurat e munguara nga mungesa e kontrollit të zbatimit të LN për 2014, v. 2015 dhe 2016", bashkëlidhur (Trajtuar hollësisht ne faqet nr. 108-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me IMTV të marrin masat për ushtrimin e kontrollit të zbatimit të lejeve të ndërtimit lidhur me ecurinë e fazave të procesit të punimeve dhe afatet, **14 leje ndërtimit** prej 131 gjithsej si dhe të marrin masat e duhura administrativo–ligjore për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **1,400,000 lekë vlerë e gjobave** të pa aplikuar nga mos kontrolli në kohë sipas fazave të ndërtimit, pasqyruar në tabelën emërtuar "Të ardhurat e munguara nga mungesa e kontrollit të zbatimit të LN për 2014, 2015 dhe 2016"

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Shkodër (Autoriteti Zhvillimit Territorit), për periudhën 2014-2016 janë zbatuar procedurat ligjore e janë dhëne **71 leje** përdorimi përkatësisht **40 leje përdorimi** në vitin 2014, **29 leje përdorimi** në vitin 2015 dhe **2 leje përdorimi** në vitin 2016, duke reflektuar ecuri të ngadaltë të lëshimit të lejeve të përdorimit. Nga mos ndjekja e afateve të lejeve të ndërtimit, rezulton se janë lëshuar 19 leje përdorimi tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 6 muaj deri në 4 vjet, në kundërshtim me afatet e miratuara, shoqëruar kjo situatë me vlerën e të ardhurave të munguara **nga mos aplikimi i gjobave në masën 1,900,000 lekë (600,000+1,300,000)**, kjo bazuar në nenin 11, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", dhe me nenin 52, pika a,b,c të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", pasqyruar në tabelën emërtuar: "Lejet e Përdorimit te Miratuara dhe Mungesa e Aplikimit të Gjobave për Vonesat Viti 2015-2016, konkretisht: Për vitin 2014 janë lëshuar 17 leje përdorimi, tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 6 muaj deri në 4 vjet, duke shkaktuar të ardhura të munguara nga mos aplikimi i vlerës së gjobës në vlerën 1,700,000 lekë, për vitin 2015 janë lëshuar 2 leje përdorimi tej afateve të lejes së ndërtimit me vonesë nga 1 vjet deri në 2 vjet, duke shkaktuar të ardhura të munguara nga mos aplikimi i vlerës së gjobës në vlerën 200,000 lekë (Trajtuar hollësisht ne faqet nr. 108-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, (Autoriteti Zhvillimit Territorit), nga Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban në bashkëpunim me IMTV të marrin masat e duhura administrativo–ligjore, të procedojnë për aplikimin e gjobave dhe arkëtimin e vlerës së të ardhurave të munguara **në vlerën 1,900,000 lekë gjobë e pa aplikuar** që iu përkasin të **17 leje përdorimi** lëshuar **në vitin 2014** tej afateve të lejes së ndërtimit dhe për **2 leje përdorimi** në vitin 2016 tej afateve të lejes së ndërtimit.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër, nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit përbërës të dosjeve të lejeve të ndërtimit (Lejeve zhvillimore) u konstatuan se gjendja e inventarizimit të 202 dosjeve, (131 dosje leje zhvillimi dhe 71 dosje leje përdorimi), është e paraqitur vetëm me listë emërtimi dokumentesh pa numër përkatës fletësh të secilit dokumenti përbërës të dosjes si dhe dosjet ndodhen në arkivin e urbanistikës të pa dorëzuara në arkivin e bashkisë, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.01.1993 "Për Arkivat" , pasqyruar në tabelat emërtuar: "Të ardhurat e munguara dhe dëmi ekonomik nga mungesa e kontrollit të zbatimit të LN për v. 2014, v. 2015 dhe 2016" ,"Lejet e Përdorimit te Miratuara dhe Mungesa e Aplikimit të Gjobave për Vonesat Viti 2014, 2015-2016 Tabela nr.2.1, 2.2 dhe

2.3”, bashkëlidhur (*Trajtuar hollësisht ne faqet nr.108-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të marrë masa të inventarizojë dhe dorëzojë në arkiv **202** dosjet, (**131** dosje leje zhvillimi dhe **71** dosje leje përdorimi) me numër fletësh progresiv për çdo dosje dhe çdo emërtimi dokumentesh përbërës të dosjeve, konformë ligjit të inventarizimit dhe administrimit të dokumenteve arkivor.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, sipas raportit përmbledhës nr. 2431/b, datë 17.10.2016, procesverbalit “Për marrje dorëzim të pyje kullotave, mjedisit dhe ish-Komunave së bashku me listat e inventarit“ dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim të pajisjeve teknike dhe Know How ka marrë në dorëzim ndërmjet të tjerash:

Plane Menaxhimi të Pyjeve dhe kullotave Komunale copë 4 (3 copë përkatësisht: për ish-Komunat Shosh, Guri Zi, Shalë, si dhe 1 për EP Cukal). Gjithashtu dhe Plane Mbarështimi 3 cope përkatësisht: të ish-Komunave Shllak, Temal dhe Bashkisë Vau Dejës, te cilat janë marrë në dorëzim jashtë të drejtës, pasi ndodhen jashtë juridiksionit të Bashkisë Shkodër dhe duhet tu dorëzohen njësisive përkatëse Bashkisë Vau Dejës, veprim që bie në kundërshtim me VKM nr. 433, datë 08.6.2016 “Për Transferimin në Pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas Listave të Inventarit dhe aktualisht në Administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive” dhe Urdhrin nr. 4632, datë 18.7.2016 “Mbi dorëzimin e pyjeve dhe kullotave në Bashki”, të Ministrit të Mjedisit (*Trajtuar hollësisht në nr. faqet 112-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, të marrë masa të dorëzojë zyrtarisht me procesverbal *njësive përkatëse Bashkisë Vau Dejës, 3 cope Plane Mbarështimi përkatësisht: të ish-Komunave Shllak, Temal dhe Bashkisë Vau Dejës, te cilat janë marrë në dorëzim jashtë të drejtës, pasi ndodhen jashtë juridiksionit të Bashkisë Shkodër.*

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, ka marrë në dorëzim **6 plane Mbarështimi** *qe i përkasin ish-Komunave Shosh prej v.2008, Guri Zi prej v.2008, Shal prej v.2009, Postrribë prej v.2007 dhe Pult prej v.2008 si dhe 1 për EP Cukal*), me afat 10 vjeçar shtrirje deri 2017-2018-2019, me vlera të dokumentacionit dhe njohurive Know-how, por në marrjen në dorëzim nga pala dorëzuese nuk jepen të dhëna dokumente për ecurinë e zbatimit të tyre, qe do të ndihmonte nismën për vlerësimin e vazhdimin të zbatimit të tyre në periudhën e mëvonshme nga Bashkia Shkodër, me synim vënien nën administrim, menaxhim të fondit pyjor prej mbi **43 806 ha** (prej saj **6 685 ha sipërfaqe** inproduktive e djerrë e mundshme për shtim të fondit), gjenerimin e të ardhurave dhe punësimin e komunitetit të zonave rurale, vendosjen dhe inicimin e bashkëpunimit me shoqatat e përdorimit të pyjeve kullotave e operatoreve të tjerë në këtë fushe, por edhe përdorimin e burimeve të ardhurave nga pyjet për zhvillimin e qëndrueshëm, sipas destinacionit ligjor; gjendje kjo në kundërshtim me pikën 6 të shkresës nr 7531, datë 28.12.2015 “Mbi marrjen e masave për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave”, të Ministrit të Mjedisit për “shqyrtimin e planeve të Mbarështimit për fondin Pyjor dhe Kullosor”.

Gjithashtu mungon plani operacional vjetor për vitin 2016 për aktivitetet vjetore ne pyje kullota bazuar në të dhënat e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve për vitin referues sipas planeve të mbarështimit dhe mungojnë përfshirja në planin vjetor buxhetor “Programi i pyjeve dhe kullotave”, pra në përfshirje dhe apo ndryshime në Buxhetin korrent 2016 të Bashkisë, në kundërshtim me pikën 7 dhe 17 të urdhrin të ministrit të Mjedisit nr 7531, datë 28.12.2015 (*Trajtuar në faqet 112-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa të rishqyrtojë e vlerësoje dhe verë në efikasitet zbatimin e **6 planeve të mbarështimit përkatësisht:** Planit Menaxhimit të pyjeve për

ish-Komunat Shosh prej v.2008, Guri Zi prej v.2008, Shal prej v.2009, Postrribë prej v.2007 dhe Pult prej v.2008 si dhe 1 për EP Cukal), me afat 10 vjeçar shtrirje deri v.2017-2019, si dhe të hartojë planin operacional vjetor për aktivitetet vjetore ne pyje kullota bazuar në të dhënat e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve, me synim vënien nën administrim, menaxhim të fondit pyjor prej **43 806 ha** (prej saj 6 685 ha inproduktive djerrë e mundshme për shtim të fondit), gjenerimin e të ardhurave dhe punësimin e komunitetit të zonave rurale, vendosjen dhe inicimin e bashkëpunimit me shoqatat e përdorimit të Pyjeve kullotave e operatorëve të tjerë në këtë fushë, si dhe përdorimin e burimeve të ardhurave nga pyjet për zhvillim të qëndrueshëm, sipas destinacionit ligjor.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër, nisur nga struktura dhe shpërndarja e fondit pyjor kullor prej **43806 ha**, nuk evidentohet nga ish-Komunat dhe Bashkia asnjë produkt kryesor si dru zjarri, lëndë dhe as produkte dytësore si bimë mjekësore e tanifere të vjelë prej fondit pyjor megjithëse marrja në dorëzim nga Bashkia është bërë deri fund viti 2016, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, të ndryshuar me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (Trajtuar në faqet nr. 112-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, të marrë masa të evidentojë, parashikojë, programojë e vjelë produktet kryesore si dru zjarri, lëndë me prejardhje nga zbatimi i Planeve të Menaxhimit në respekt të Memorandumeve, si dhe produktet dytësore si bime mjekësore e tanifere nëpërmjet Shoqatave përkatëse dhe operatoreve të tjerë, mbështetur në strukturën dhe shpërndarjen e fondit pyjor kullor prej **43806 ha**, si dhe të ardhurat **ti përfshijë dhe shpërndajë në PB dhe PBA përkatëse**, në zbatim të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, të ndryshuar me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

20. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër me VKM nr. 421, datë 2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen ne pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” **ka në pronësi objektin “Kinema Milenium”**, me nr. 219, në listën e inventarit të pronave, me truall funksional 811 m² sipërfaqe ndërtimi 680 m² nga e cila sipërfaqja 466 m² truall funksional dhe 667 m² ndërtesë janë dhënë me qira me kontratën nr. 650 rep, nr. 133 kol. datë 24 mars 2000, lidhur ndërmjet ish-Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (MEPP) dhe Shoqërisë “I” sh.a; kontratë e cila nuk disponohet, nuk i është bërë e njohur Bashkisë nuk është përditësuar pas VKM-së së ndryshimit të pronësisë mbi këtë aktiv. Konstatohet mungesa e informacionit dhe transparenca e sipërfaqeve në shfrytëzim apo përdorim. Nuk ka informacion për shlyerjen e detyrimit kontraktor të qiramarrjes nga ana e shoqërisë “I”, por është e sigurt që në buxhetin e Bashkisë mungon vlera pre **10,611,720 lekë** si nivel qiraje e derdhur në llogaritë e Bashkisë për periudhën 7 vjet (2010-2017), në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, VKM nr. 421, datë 2.06.2010, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, dhe me nenet 801-805 të Kodit Civil “Kontrata e Qirasë”, (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 123-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve të marrë masa të administrojë e kërkoj zyrtarisht dokumentacionin lidhur me këtë marrëdhënie kontraktore. Të shqyrtojë e vlerësojë plotësimin e detyrimeve të palëve të kontratës nr. 650 rep, nr. 133 kol. datë 24 mars 2000, me objekt dhënien me Qira të objektit “Kinema Millenium” Shkodër

pronë e Bashkisë lidhur ndërmjet ish-Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe x sh.a, si dhe të vendosë për vijimësinë e kësaj kontrate.

Menjëherë

21. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër 3 objekte kopshte me funksion arsimit parashkollor, me sipërfaqe totale 4056 m², me sipërfaqe ndërmore 815 m² përkatësisht: Kopshti lagja “Ndoc Mazi”, Kopshti Zdrale, Kopsht “Daniel Matlia” (nr. 69,71,72 të listës së VKM nr. 421) janë zaptuar pa tituj pronësie nga qytetarët dhe përdoren për banim e aktivitete të tjera, duke sjellë kështu ndërprerjen e funksionit arsimor parashkollor publik, në kundërshtim me VKM nr. 421, datë 2.06.2010, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pasqyruar në tabelën “Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion arsimit parashkollor apo të tjera” (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 122-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve të marrë masa në bashkëpunim me Organet e Rendit për çlirimin nga zaptimi i jashtëligjshëm dhe vënien në funksion të arsimit parashkollor të tre objekteve me funksion arsimit parashkollor prone publikë e Bashkisë përkatësisht: Kopshti lagja “Ndoc Mazi”, Kopshti Zdrale dhe Kopsht “Daniel Matlia” (nr. 69,71,72 të listës së VKM nr.421).

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Postribë, aktualisht NJA Bashkia Shkodër, nuk është kryer inventarizimi, identifikimi dhe marrja nën administrim i pasurive kaluar në pronësi me VKM nr. 477, datë 29.06.2011 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Komunës Postribë, të Qarkut të Shkodrës”, ndërsa prej viteve 2012-2016 janë zaptuar **6 objekte ndërtesa me funksion zhvillimi ekonomik me sipërfaqe trualli prej 16906 m² në pronësi të Bashkisë me 16 906 m² ndërtesa, ndodhur në fshatrat Mes, Myselim, Drisht, Dragoç dhe Kullaj që përdoren për banesa nga qytetarët; ndërsa Terreni Sportiv i Fshatit Dragoç, fusha e sportit me sipërfaqe 13000 m² është zaptuar dhe mbjellë me Ullishtë pa titull pronësie,që kanë sjellë si pasojë ndryshim të qëllimit e funksioneve; gjendje në kundërshtim me VKM nr. 477, datë 29.06.2011 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Komunës Postribë, të Qarkut të Shkodrës”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, pasqyruar në tabelën emërtuar: ”Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion ekonomik dhe terren sportiv, apo të tjera të ish-Komunës (NJA) Postribë “(*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 124-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).**

22.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve, NJA Postribë të marrë masa në bashkëpunim me Organet e Rendit për çlirimin nga zaptimi i jashtëligjshëm dhe vënien në funksion të **6 objekteve ndërtesa me funksion zhvillimi ekonomik me sipërfaqe trualli prej 16906 m² në pronësi të Bashkisë me 16906 m² ndërtesa, ndodhur në fshatrat Mes, Myselim, Drisht, Dragoç dhe Kullaj të zaptuara e që përdoren për banesa nga qytetarë dhe të objektit Terren Sportiv (Fusha sportit) Fshati Dargoç, me sipërfaqe 13000 m² e zaptuar dhe mbjellë me Ullishtë pa titull pronësie, (përkatësisht nr.34, 35, 36, 37, 38, 39 dhe nr. 520 të listës së VKM nr. 477, datë 29.06.2011).**

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Ana e Malit, aktualisht NJA Bashkia Shkodër, nuk është kryer inventarizimi identifikimi dhe marrja nën administrim i pasurive kaluar në pronësi me VKM nr. 552, datë 16.01.2013 “Për Miratimin e Listës Paraprake të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Komunës Ana e Malit, të Qarkut të Shkodrës”, ndërsa prej viteve 2012-2016 janë zaptuar **5 objekte ndërtesa 2 zyra 1 ofiçinë dhe 2 stalla, me funksion zhvillimi ekonomik me sipërfaqe trualli prej 1500**

m² në pronësi të Bashkisë me sipërfaqe ndërtimi 900 m² ndërtesa, ndodhur në fshatin Oblikë përdoren për banesa nga qytetarët; që kanë sjellë si pasojë ndryshim të funksionit dhe qëllimit funksional të përdorimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, VKM nr. 552, datë 16.01.2013, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, pasqyruar në tabelën emërtuar: "Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona me funksion ekonomik apo të tjera Ish-Komuna Ana Mali, NJA "(Trajtuar hollësisht në faqet 127-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve, NJA Ana Mali të marrë masa të identifikojë nëse disponojnë tituj të Pronësisë dhe në bashkëpunim me Organet e Rendit të veprojnë për çlirimin nga zaptimi i jashtëligjshëm dhe vënien në funksion të Bashkisë të **5 objekte ndërtesa 2 zyra 1 oficinë dhe 2 stalla me funksion zhvillimi ekonomik me sipërfaqe trualli prej 1500 m² në pronësi të Bashkisë me sipërfaqe ndërtimi 900 m² ndërtesa të zaptuara e që përdoren për banesa nga qytetarë pa titull pronësie**, (përkatësisht nr. 19, 20, 21, 22 dhe nr. 23 të listës së VKM nr. nr. 552, datë 16.01.2013).

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër IMT ka në proces arkëtimi ne përmbarrimin gjyqësor vjeljen e 44 gjobave me vlerën totale **23,048,666 lekë** prej të cilave: 14 gjoba me vlerë **8,300,000 lekë të vitit 2012**, 21gjoba me vlerë **13,498,666 lekë të vitit 2013**, (veçuar 9 gjoba me vlerë 9,648,666 lekë me kamatëvonesën 2%, ndërsa 13 gjoba me vlerë **3,850,000 pa kamatëvonesë**), 8 gjoba me vlerë 750,000 lekë, pa kamatëvonesë të vitit 2014, dhe 1 gjobë me vlerë 500,000 lekë pa kamatëvonesë e vitit 2015, pasqyruar në tabelën emërtuar "Gjendje gjoba të pa arkëtuara për periudhën deri 31Dhjetor 2015-31 Dhjetor 2016".

Në vlerën e gjobave 2012-2015 nuk janë llogaritur e kërkuar vlera e 2% kamatë vonesë, pra në përmbarrim nuk është llogaritur përfshirë e kërkuar për 44 gjoba vlera **totale prej 31,088,666 lekë, kamatëvonesa**, duke lënë jashtë llogaritjes e kërkimin për 38 gjoba me vlerën **13,400,000 lekë**, vlerën e **kamatëvonesës prej 8,040,000 lekë që përbën dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara** (ndarë: 4,980,000 lekë kmv për 14 gjoba me vlerë 8,300,000 lekë të v.2012, dhe 2,300,000 lekë për 13 gjoba me vlerë 3,850,000 lekë të v.2013, dhe vlerën e kamatë **vonesës prej 450,000 lekë** për 8 gjoba me vlerë 750,000 lekë të v.2014 si dhe vlerën e kamatëvonesës prej **300,000 lekë** për 1 gjobe me vlerë 500,000 lekë të v.2015), pasqyruar në tabelën emërtuar "Gjendje gjoba të pa arkëtuara për periudhën deri 31 Dhjetor 2015-31 Dhjetor 2016 vendosur nga IMT";

Për vitin 2016 nga IMT Bashkia Shkodër për 22 gjoba me vlerën 4,600,000 lekë pa kamatë vonesa janë pa likuiduar 9 gjoba me vlerë 3,650,000 lekë pa kamatëvonesa dhe janë likuiduar 13 gjoba me vlerë 950,000 lekë pa kamatëvonesa, pra nuk është llogaritur ndalur dhe kërkuar vlera e kamatëvonesës prej **1,105,000 lekë duke rezultuar në të ardhura të munguara** (ndarë; 890,000 lekë për 9 gjoba me lerën 3,650,000 lekë debitorë te pa likuiduara dhe 215,000 lekë për 13 gjoba me vlerë 950,000 lekë të likuiduara pa kamate, ndërkohe që si pasojë e mungesës së vendosjes së mekanizmave të kontrollit të brendshëm duheshin llogaritur përfshirë e kërkuar e likuiduar vlera me kamatë vonesa prej 4,755,000 lekë për 22 gjoba ndarë: për 9 gjoba të pa likuiduara me vlerë 4,540,000 lekë, prej saj 890,000 lekë kmv dhe për 13 gjoba të likuiduara në vlerën 950,000 lekë pa kërkuar e arkëtuar kmv prej 215,000 lekë, pasqyruar në tabelën emërtuar "Debitorët e gjobave vendosur nga IMT V.2016"; gjendje kjo për periudhën para v.2014, v.2014, 2015 dhe v.2016 ne kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", neni 16 dhe me ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative", neni 9, 22 "Ekzekutimi i kundravajtjeve administrative" (Trajtuar në faqet 131-134 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, IMT dhe Drejtoria Juridike të marrin masa të ndjekin të gjitha hapat dhe procedurat ligjore e gjyqësore për arkëtimin e vlerës totale **prej 44,988,000 lekë** nga e cila vlera prej **35,843,000 lekë vlera e gjobave ne përmbarrim** dhe vlera e kamatëvonesave të pa kërkuara e llogaritur për gjobat në përmbarrim e në gjykatë dhe

vlera prej 9,145,000 lekë kamatëvonesa të pa llogaritura e kërkuara për gjobat e viteve 2012-2015 dhe vitit 2016 pasqyruar në tabelat “Gjendje gjoba të pa arkëtuara për periudhën deri 31 Dhjetor 2015-31 Dhjetor 2016”, “Gjendje gjoba të pa arkëtuara për periudhën deri 31 Dhjetor 2015-31 Dhjetor 2016 vendosur nga IMT”; dhe në tabelën në tabelën emërtuar “Debitorët e gjobave vendosur nga IMTV v.2016”.

Deri shkurt 2018

25. Gjetje nga auditimi: Brenda fondit pyjor kullisor të transferuar në pronësi të Bashkisë Shkodër ndodhen edhe 11 antena për të cilat janë lidhur kontratat në sipërfaqen 2650 m² fond pyjor dhe që shfrytëzojnë 4,411 km rrugë brenda fondit, për të cilat nga Bashkia Shkodër e cila tashmë zotëron titujt e pronësisë, nuk zotërohen kontratat dhe nuk merret asnjë e ardhur, për shkak të administrimit të tyre nga Ministria e Brendshme sipas VKM nr. 338, datë 6.6.2007 “Për Ndryshimin e Përgjegjësisë së Administrimit të Pasurive Toka Pyjore Publike ku janë Ndërtuar Stacione Bazë të Transmetimeve të Sinjaleve BTS nga Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave”. Konstatohet se Bashkia nuk ka ndërmarrë asnjë hap ligjor a korrespondencë, me Ministrinë e Brendshme dhe nuk vjel asnjë të ardhur nga këto kontrata, në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullisor publik, sipas legjislacionit në fuqi*, ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullisor”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Antena të telefonisë celulare të transferuara në përgjegjësi administrimi MB me VKM nr. 338, datë 6.06.2007, brenda fondit Pyjor me pronësi të Bashkisë Shkodër *(Trajtuar në faqet 116-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

25.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa të rakordojë me Ministrinë e Brendshme për marrjen dhe vënien nën administrim të 11 kontratave që i përkasin 11 antenave për të cilat janë lidhur kontratat në sipërfaqen 2650 m² fond pyjor dhe shfrytëzojnë 4,411 km rrugë brenda fondit, të ndodhura brenda fondit pyjor për të cilat Bashkia Shkodër tashmë zotëron titujt e pronësisë, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 22 pika 4 dhe neni 27 pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullisor publik, sipas legjislacionit në fuqi*, Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, sipas tabelës emërtuar “Antena të telefonisë celulare të transferuara në përgjegjësi administrimi MB me VKM nr. 338, datë 6.06.2007, brenda fondit Pyjor me pronësi të Bashkisë Shkodër”.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Sipas VKM nr. 433/2016, pika 48, pasuritë që përbëjnë Fondin pyjor/kullisor që i kalon në pronësi Bashkisë Shkodër janë gjithsej 2160 pasuri, ndërsa sipas azhornimit të fundit të kryer aktualisht numri shkon në 2117 pasuri. Nga dalja e VKM nr 433/2016 dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit mbi fondin pyjor/kullisor janë përgatitur dhe dërguar për regjistrim pranë ZVRPP Shkodër 318 prona, nga pasuria me nr 1620 deri tek pasuria me nr 1937. Ky dokumentacion është përcjellë me shkresën nr. 13944, datë 26.10.2016, ndërsa nga ZVRPP Shkodër nuk është bërë asnjë regjistrim i këtyre pasurive me argumentin se: Fondi Pyjor/kullisor është jashtë Zonave Kadastrale të përcaktuara dhe deri në krijimin e këtyre zonave nuk pranojnë asnjë aplikim për regjistrim, për të cilat Bashkia ka paguar shpenzimet për aplikim vlerën prej **462,000 lekë**, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” *(Trajtuar në faqet nr 117-118, 120-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

26.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të marr masa të prezantojë problemin në ZQRPP të rakordojë me ZVRPP Shkodër dhe të kërkoj regjistrimin e 318 pasurive pyjore për të cilat është paguar vlera e aplikimit dhe shërbimi nuk është marr, në të kundërt të kërkoj kthimin e vlerës prej **462,000 lekë**.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Shkodër i janë transferuar e kaluar në pronësi pasuritë e ish-Bordi i kullimit Shkodër me Sipërfaqe trualli 10200 m², nga kjo ndërtesë 1. Zyra 1669 m², dhe 2. Ofiçinë+magazinë 3250,5 m², sipas VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”.

Nga identifikimi i gjendjes juridike me proces verbalin e transferimit dhe marrjes në dorëzim të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme mbajtur nga bashkia me ish-Bordin, dhe sipas konfirmimit të ZVRPP Shkodër me shkresën nr. 912/1 prot, datë 8.03.2016 rezulton se:

1. Pasuria nr.10/80/1 Vol 10, faqe 100, me sipërfaqe 2300 m² e trashëgimtarëve F K K (te cilët në vend kanë rrethuar me shume se sipërfaqja përcaktuar në certifikate pronësie).

2. Pasuria 10/505 Vol 43, faqe 65 në favor të x

Gjendja e mësipërme me pasojë zotërime pa tituj pronësie e të jashtëligjshme nga persona të pjesëve të pasurisë troje e ndërtesa që i përkasin ish-Bordit të Kullimit është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit” (*Trajtuar në faqet nr. 121-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

27.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve të marrë masa të ndjekë në rrugë ligjore dhe në Bashkëpunim me organet e Rendit, të kërkoj çlirimin e pasurive të zaptuara e pa tituj pronësie pronë e Bashkisë që i përkasin ish-Bordit të Kullimit, duke veçuar pjesën e pasurisë të dokumentuar me Titullin Origjinal të Pronësisë, të marr dhe vendosë nën administrim pasurinë e transferuar në kufijtë dhe sipërfaqen e përcaktuar nga VKM nr.1108; si dhe të llogarisë, kërkoj dhe arkëtojë vlerën e të ardhurave të munguara në nivelin e vlerës së qirasë së munguar të rrjedhur nga zaptimi pa tituj pronësie të sipërfaqes së truallit dhe të ndërtesës nga xx

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër nga identifikimi i listave që i përkasin VKM nr. 421, datë 2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” janë identifikuar disa prona me shënimin “e zënë forcërisht”, si më poshtë:

1. Pronat me nr. 17 në listë, “Ish Zyrat e Sektorit I-rë të ish-Nd/jes Komunale Banesa me nr pasurie 2/51,2/52,2/53 në zonën kadastrale 8594 regjistruar në emër të familjes xx sipas konfirmimit, nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr.3508/1 prot, datë 25.03.2011 në kthim përgjigjeve të shkresave të Bashkisë që ka dërguar për regjistrim pronën me shkresën nr. 2962 prot, datë 06.09.2010. Certifikatë për vërtetim pronësie regjistruar në vol 22, faqe 128, data e lëshimit të certifikatës 06.06.2001.

2. Pronat me nr. 18, në listë “Zyra e magazinë sek I-re ish-Nd/jes Komunale Banesa”, regjistruar në emër të xx kjo bërë me dije nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr.3508/1 prot, datë 25.03.2011 në kthim përgjigjeve të shkresave të Bashkisë që ka dërguar për regjistrim pronën me shkresën nr. 2962 prot, datë 06.09.2010.

3. Pronat me nr.inv.19 në listë “Ish dekori” ish-Nd/jes Komunale Banesa regjistruar në emër të familjes xx kjo bërë me dije nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr. 3508/1 prot, datë 25.03.2011 në kthim përgjigjeve të shkresave të Bashkisë që ka dërguar për regjistrim pronën me shkresën nr. 2962 prot, datë 06.09.2010, Regjistruar në Vol 23, faqe 245, ref 5380 me kontratë shitje nga Agjencia e Privatizimit, dega Shkodër (*Trajtuar në faqet nr. 122-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve të marr masa të ndjekë në rrugë ligjore të bëjë identifikimin e plotë të origjinës së pasurive të regjistruara dhe

konfirmuara nga ZVRPP Shkodër duke zotëruar dokumentacionin përkatës, pra të pasurive që përfshihen në listat e VKM nr. 421, datë 2.06.2010 kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër dhe të ndjekë hapat për identifikim konkretisht:

1. Për Pronat me nr. 17 në listë, objekti “Ish Zyrat e Sektorit I-rë të ish-Nd/jes Komunale Banesa dhe Pronat me nr. 18, në listë objekti “Zyra e magazinë sek I-re ish-Nd/jes Komunale Banesa” dhe pasuritë nr. 2/51,2/52,2/53 ZK 8594, konfirmuar nga ZVRPP me shkresën nr.3508/1, datë 25.03.2011 dhe regjistruar ne emër te familjes xx pasuritë nr. 2/51,2/52,2/53 zk 8594 vol 22, faqe 128, lëshuar certifikate datë 06.06.2001, *të kërkohet dokumenti i origjinës së pronës së regjistruar dhe dokumenti procesverbali i dorëzimit të pronës nga Ish-nd/ja Komunale apo Bashkia si dhe të behet bilanci i pasurive të llojit truall e ndërtesë të regjistruar nga ZVRPP, bilanci të krahasohet me sipërfaqen e truallit dhe të Ndërtesës përcaktuar nr. 17, nr.18 në listë, objekti ”Ish Zyrat e Sektorit I-rë të ish-Nd/jes Komunale” dhe objekti “Zyra e magazina sek I-re ish-Nd/jes Komunale Banesa” sikundër përcaktuar në VKM nr.421.*

2. Për Pronat me nr.inv.19 në listë objekti “Ish dekori” ish-Nd/jes Komunale Banesa, konfirmuar nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr.3508/1 prot, datë 25.03.2011 regjistruar ne emër te familjes xx ne Vol 23, faqe 245, ref 5380 me kontrate shitje nga Agjencia e Privatizimit, dega Shkodër, *të kërkohet dokumenti i origjinës së regjistrimit kontrate shitje i Agjencia e Privatizimit, dega Shkodër, së bashku me genplanin përkatës, likuidimi i vlerës ndërtimore të objektit dhe truallit (nëse nuk është i kthyer) dhe procesverbali i dorëzimit të pronës nga ISH-nd/ja Komunale apo Bashkia si dhe të bëhet bilanci e të krahasohet me sipërfaqen e truallit dhe të Ndërtesës përcaktuar në nr inv.19 në listë “Ish dekori” ish-Nd/jes Komunale Banesa, sikundër përcaktuar në VKM nr.421.*

Pas përputhshmërisë ligjore të titujve të pronësisë dhe disponimit të dokumenteve përkatës dhe përputhshmërisë të sipërfaqeve te trojeve dhe sipërfaqeve ndërtimore, dhe pas justifikimit me dokumente të likuidimit të vlerave eventuale, këto pasuri me VKB të posaçëm hiqen nga lista e inventarit të pronave të VKM nr.421, datë 2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen ne pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”.

Menjëherë

29. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër nga identifikimi i listave që i përkasin VKM nr. 421, datë 2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen ne pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” janë identifikuar Pronat me nr. inv.22, objekti “Ish Zyrat e rajonit tek Artistikja, nr. 23 objekti “Ish Zyrat e rajonit tek Artistikja” ne pronësi te familjes xx Origjina e te drejtës se pronësisë Vendimi nr. 310, date 29.11.1994, KK Pronave Shkodër, qe ka njoh te drejtën e parablerjes te realizuar me kontrate shitblerje e date 22.01.1997 nga trashëgimtarët xx e regjistruar pranë ZVRPP Shkodër (*Trajtuar në faqet nr. 122-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

29.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve të marr masa të ndjek në rrugë ligjore të bëj identifikimin e plotë të origjinës së pasurive të regjistruara dhe konfirmuara nga ZVRPP Shkodër duke zotëruar dokumentacionin përkatës, pra të pasurive që përfshihen në listat e VKM nr. 421, datë 2.06.2010 kaluar në pronësi të Bashkisë Shkodër dhe të ndjek hapat për identifikim konkretisht:

Për pronat me nr.inv.22 dhe nr.23 në listë objekti “Ish Zyrat e rajonit tek Artistikja” *të kërkohet dokumenti i origjinës së regjistrimit Vendimi nr. 310, date 29.11.1994 të KK Pronave Shkodër së bashku me genplanin përkatës, likuidimin e vlerës ndërtimore të objektit dhe truallit (nëse nuk është i kthyer) dhe procesverbali i dorëzimit të pronës nga Ish-nd/ja Artistike apo Bashkia si dhe të bëhet bilanci të krahasohet me sipërfaqen e truallit dhe të Ndërtesës përcaktuar në inv. nr. 22 dhe nr.23 në listë objekti ”Ish Zyrat e rajonit tek Artistikja”, sikundër përcaktuar në VKM nr.421.*

Pas përputhshmërisë ligjore të titujve të pronësisë dhe disponimit të dokumenteve përkatës dhe përputhshmërisë të sipërfaqeve të trojeve dhe sipërfaqeve ndërtimore dhe pas justifikimit me dokumente të likuidimit të vlerave eventuale, këto pasuri me VKB të posaçëm hiqen nga lista e inventarit të pronave të VKM nr. 421, datë 2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër të Qarkut të Shkodrës” përkatësisht pasuritë pronat me nr.22 dhe nr.23 që i përkasin objektit ”Ish Zyrrat e rajonit tek Artistikja”.

Menjëherë

30. Gjetje nga auditimi: Nga bashkia Shkodër nuk janë identifikuar e marr nën administrim objekte, troje e asete të tjera si: 3 objekte ekonomike arsimore me sipërfaqe totale 2229 m² prej saj sipërfaqe ndërtimore 1948 m² përkatësisht objekti “Thertore” tek Ura e Bunës, nr. Inv. 107, sip totale të pronës 1253 m², nga kjo 972 m² ndërtesë, objekti “Çerdhe” tek zooteknika, nr. Inv. 246 sip totale të pronës 234 m², nga kjo sip nd. 234 m², objekti “Konvikti i shkollës veterinare”, nr. Inv. 63, me sip totale 742 m², sip nd 742 m²; gjendje që ka sjellë si pasojë përdorim të paligjshëm pa tituj pronësie nga persona të ndryshëm me ndërtime apo me ushtrime aktivitete, përdorim për banese dhe për të cilat nuk identifikohen përdoruesit, nuk është llogaritur e ardhura e munguar, si dhe nuk është vendosur statusi ligjor i përdoruesit; gjendje në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 i ndryshuar, VKM-në nr. 421, datë 2.06.2010, VKM nr. 421, datë 14.06.2010, dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014 (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 123-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve të marr masa në bashkëpunim me Organet e Rendit për çlirimin nga zaptimi i jashtëligjshëm dhe vënien në funksion të arsimit parashkollor, shkollor dhe ekonomik nga përdorimi *me ndërtime apo me ushtrime aktivitete të ndryshme përdorim për banese përdorim të jashtëligjshëm dhe pa tituj pronësie nga persona të ndryshëm, 3 objekte ekonomike arsimore me sipërfaqe totale 2229 m² prej saj sipërfaqe ndërtimore 1948 m² përkatësisht objekti “Thertore” tek Ura e Bunës, nr. Inv. 107, sip totale të pronës 1253m², nga kjo 972m² ndërtesë, **Objekti** “Çerdhe” tek zooteknika, nr. Inv. 246 sip totale të pronës 234m², nga kjo 234 m², **objekti** “Konvikti i shkollës veterinare”, nr. Inv. 63, me sip totale 742 m², sip nd 742 m², për të cilat të vendoset statusi ligjor i përdoruesit në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore.*

Menjëherë

31. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Guri i Zi, aktualisht NJA Bashkia Shkodër, nuk është kryer inventarizimi identifikimi dhe marrja nën administrim i **383** pasurive prej të cilave 78 pasuri-prona me status juridik në pronësi, 33 prona-pasuri me status në përdorim dhe 272 prona-pasuri në juridiksion, transferuar me VKM nr. 1088, datë 23.7.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Komunës Gur i Zi, të Qarkut të Shkodrës”, ndërsa prej viteve 2008-2016 përveç sa sipër evidentohen mangësi të theksuara lidhur me administrimin vënien në efikasitet dhe sidomos lidhur me mungesën e treguesve identifikues dhe konkretisht;

Prona me nr. 255 “tokë bujqësore inproduktive” Komuna Gur i ZI me sipërfaqe 5299 ha nuk është e plotësuar me të dhëna kadastrale, nuk ka mundësi të identifikohen. Pronat me fushë përdorimi “Arsim” nuk kanë të dhënat kadastrale, mungojnë indekset e hartave dhe numrat e pasurive, të cilët sjellin pasoja në regjistrimin e këtyre pronave.

Pronat me fushë përdorimi “Shëndetësi” nuk janë të plotësuar formularët me numra pasurie mungojnë indekset e hartave dhe numrat e pasurive, të cilët sjellin pasoja në regjistrimin e këtyre pronave.

Pronat me fushë përdorimi “Infrastrukturë shërbime publike varreza”, nuk janë të plotësuar formularët me numra pasurie mungojnë indekset e hartave dhe nr e pasurive, të cilët sjellin pasoja në regjistrimin e këtyre pronave; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme dhe VKM nr. 1088, datë 23.7.2008 “Për Miratimin e

Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen, në Pronësi ose Përdorim, të Komunës Gur i Zi , të Qarkut të Shkodrës”, me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (Trajtuar në faqet 129-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

31.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria Juridike dhe Aseteve, NJA Guri i Zi të marr masa të identifikojë marr nën administrim **383 pasuritë** prej të cilave 78 pasuri-prona me status juridik në pronësi, 33 prona-pasuri me status në përdorim dhe 272 prona-pasuri në juridiksion transferuar me VKM nr.1088, datë 23.7.2008,

Të inventarizojë gjendjen aktuale të posedimit dhe të përcaktojë treguesit identifikues përkatësisht;

Për pronën me nr. 255 “tokë bujqësore inproduktive” me sipërfaqe 5299 ha të identifikohen dhe plotësohen të dhëna kadastrale dhe posedimi,

Për Pronat me fushë përdorimi “Arsim” të identifikohen të dhënat kadastrale, indekset e hartave dhe numrat e pasurive, me synim mundësimin e regjistrimit e këtyre pronave në ZVRPP.

Për Pronat me fushë përdorimi “Shëndetësi” të identifikohen e të plotësohen formularët me numra pasurie dhe me indekset e hartave si dhe të Regjistrohen në ZVRPP.

Për Pronat me fushë përdorimi “Infrastrukturë shërbime publike varreza”, të identifikohen të dhënat kadastrale, indekset e hartave dhe numrat e pasurive, me synim mundësimin e regjistrimit e këtyre pronave në ZVRPP.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga IMTV Bashkia Shkodër, për periudhën 2014-2016 janë mbajtur **47 procesverbale vendime pezullimi** prej të cilave; *15 vendime për vitin 2014, prej të cilave nuk është ekzekutuar asnjë, për 6 nuk ka informacion dhe për 9 është mjaftuar vetëm vendosje gjobe; nga 6 vendime për vitin 2015 nuk është ekzekutuar asnjë dhe është mjaftuar vetëm me vendosje gjobe; dhe nga 24 vendime për vitin 2016, 1 është pajisur me leje ndërtimi 9 nuk janë ekzekutuar prishjet dhe për 14 pretendohet dhe raportohet prishja. Vendimet e pezullimit dhe prishjes janë për shkaqe se nga kontrollat e IMTV ndërtimet kanë rezultuar me shkelje dhe në kundërshtim me ligjin nr. 10119 neni 83, ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin e Territorit” neni 39 neni 52/1 52/3 gjerat “ë”, “ii” dhe me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit, pasqyruar në tabelën emërtuar: “Vendimet e Pezullimit dhe ecuria e ekzekutimit procedurave për periudhën 2014, 2015, 2016 nga IVMT Bashkia Shkodër Tabela nr.3”, (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 131-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

32.1 Rekomandim: IMTV Bashkia Shkodër të marr masa për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të ekzekutimit dhe ecurisë së vendimeve të pezullimit në vitet 2014-2016 konkretisht lidhur me gjendjen e lartë të **44 vendimeve për prishje, të pa ekzekutuara, të mbetura në proces dhe pa veprim,** për më se 1 vit.

IMTV Bashkia Shkodër të marr masa për evidentim të plotë të kontrollit të territorit mbi gjendjen e ndërtimeve pa leje si dhe të marr masa në zbatimin e menjëhershëm të **6 vendimeve për prishje të marra në vitet 2015-2016, por të pa ekzekutuara, duke dokumentuar përfundimin e procesit të prishjes** pasqyruar në tabelën emërtuar: “Vendimet e Prishjeve për periudhën 2014, 2015, 2016 nga IVMT Bashkia Shkodër Tabela nr.3”

Menjëherë

33. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Këshillit Bashkiak Shkodër, nuk është miratuar paketa e plotë me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe me ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për Policinë Bashkiake” (Trajtuar në faqet nr. 134-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

33.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Policia Bashkiake të hartojë dhe paraqitë në Këshillin Bashkiak Shkodër, paketën me llojin e kundërvajtjeve administrative si dhe nivelin

e masës së gjobës, referuar kërkesave të nenit 6 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, brenda kufirit të 20,000 lekëve.

Në mbledhjen më të afërme

34. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të mëparshëm, dërguar me shkresën nr.455/7, datë 31.07.2014, konstatohet se masa organizative për ndjekjen në rrugë ligjore nga Policia Bashkiake Shkodër, lidhur me arkëtimin e shumës **1,723,000 lekë**, si gjoba të pa arkëtuara, rezulton se është arkëtuar vetëm shuma **340,000 lekë** dhe nuk janë arkëtuar shuma prej **1,383,000 lekë** (Trajtuar në faqet nr. 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

34.1.Rekomandimi: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Financës me Drejtorinë Juridike, të marrin masat të evidentojnë vlerën e masave administrative të pa arkëtuara si dhe të ndjekin rrugën ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobave të pa mbledhura nga Policia Bashkiake në shumën **1,383,000 lekë**, në zbatim të rekomandimit të KLSH dërguar me shkresën nr. 455/7, datë 31.07.2014, si dhe të nxirret përgjegjësia për mosveprim kohor në sa rekomanduar.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 12,638,792 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Guri i Zi Shkodër nga auditimi i njëpasnjëshëm i dokumentacionit të veprimeve të kryera me arkë, u konstatua se në disa raste mandat arkëtimet e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nuk janë regjistruar e azhurnuar sistematikisht, në librin e arkës dhe në regjistrin e të ardhurave vendore.

Gjatë auditimit nga burime të ndryshme grupi i auditimit administrojë si provë materiale 8 (tetë) kopje të mandat arkëtimeve të vulosura me vulën e ish Komunës Guri i Zi Shkodër nga të ardhurat vendore në vlerën **80,060 lekë** gjithsej dhe 2 (dy) vërtetime për shlyerje të detyrimeve të biznesit të lëshuara nga ish titullari i Komunës Guri i Zi, xxx të cilat nuk janë pasqyruar në librin dhe ditarin e arkës, në kontabilitet dhe në likuidimin e detyrimeve përkatëse të tetë personave. Veprimet e mësipërme në administrimin dhe dokumentimin e vlerave monetare, janë abuzive të shkaktuara me qëllim përfitimi dhe bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 12 pika 3, neni 16 pika 2 dhe neni 23 pika 5 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Kreu IV pika 80 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ngarkojnë me përgjegjësi xx me detyrë ish Kryetar i Komunës Guri i Zi, x me detyrë ish përgjegjëse e sektorit të financës dhe xx me detyrë ish specialist finance, arkëtar (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të marr masa për arkëtimin e vlerës **80,060 lekë** si arkëtime të ardhura vendore të pa evidentuara për llogari të debitorëve, nga ish Kryetari i

Komunës Guri i Zi Shkodër xx në vlerën 26,687 lekë, ish përgjegjësi i financës xx në vlerën 26,687 lekë dhe ish arkëtari xx në vlerën 26,687 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Blloku i pallateve Vau i Dejës*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **4,442,862 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 24.07.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xx, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. - prot., datë 24.07.2014 si dhe me kontratën e kolaudimit të punimeve nr. – prot. datë 15.12.2014 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr.73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,442,862 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik xx në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 24.07.2014 me objekt “*Blloku i pallateve Vau i Dejës*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i III-të*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,355,002 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxxxx kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 si dhe me kontratën e kolaudimit të punimeve nr.– prot. datë 11.11.2015(*Trajtuar më hollësisht në faqet nr.73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,355,002 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 15.06.2015 me objekt “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i III-të*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i IV-të*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,829,238 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxxxx, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 si dhe me kontratën e kolaudimit të punimeve nr. – prot. datë 11.11.2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,829,238 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 15.06.2015 me objekt “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i IV-të*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2013*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të

punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **275,220 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 03.07.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxxxx (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr.73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **275,220 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 03.07.2013 me objekt “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2013*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2014*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **106,400 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 11.06.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxxxx (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **106,400 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 11.06.2014 me objekt “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2014*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2015*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **67,760 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 01.01.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxxxx (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **67,760 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 01.01.2015 me objekt “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2015*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2016*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **166,221 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 09.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxxxx (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **166,221 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 09.06.2016 me objekt “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2016*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Zbatim rikualifikim Urban Blloqe Banimi Qemal Dracini (pallati me Hark)” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **457,216 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 12579/15 prot., datë 12.12.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxx, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5491/15 prot., datë 12.01.2016 si dhe kontratën e kolaudimit të punimeve datë 28.02.2017 (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **457,216 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxx në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 12579/15 prot., datë 12.12.2016 me objekt “Zbatim rikualifikim Urban Blloqe Banimi Qemal Draçini (pallati me Hark)” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikualifikim urban i ambienteve të jashtme të Katedrales së Shën Shtjefnit” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të hartimit të preventivit të punimeve rezultoi një rritje e fondit limit 1,926,173 lekë pa tvsh nga të cilat vlera **127,883 lekë pa tvsh** përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Vendimi Nr.514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 2, 3 dhe 9 (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **127,883 lekë pa tvsh** nga xxxxxx në cilësinë e hartuesit të preventivit të punimeve për objektin “Rikualifikim urban i ambienteve të jashtme të Katedrales së Shën Shtjefnit”.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Sistemim blloqe banimi Bulevardi Mehmet Pashe Plaku (pallate parafabrikat)” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **232,200 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 12579/15 prot., datë 12.12.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxx kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. - prot., datë 16.06.2014 si dhe kantatën e kolaudimit të punimeve datë 02.07.2014 (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **232,200 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot datë 16.06.2014 me objekt “Sistemim blloqe banimi Bulevardi Mehmet Pashe Plaku (pallate parafabrikat)” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion linja e ndriçimit rruga Gjovalin Gjadri” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **189,363 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve

të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 27.07.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe xxxxxx, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. prot., datë 27.07.2015 si dhe kontratën e kolaudimit të punimeve datë 02.12.2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **189,363 lekë pa t.v.sh** nga xxxxxxxx në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot datë 27.07.2015 me objekt “*Rikonstrukcion linja e ndriçimit rruga Gjovalin Gjadri*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Shkodër, grupi përkatës nuk janë dokumentuar marrja në dorëzim i kontratave dhe dokumentacioni përkatës origjinal i qiradhënies për 2 kontrata nga ish- DSHP Shkodër dhe 1 Kontratë nga ish- Komuna Guri i Zi të lidhura me xx për dhënie sipërfaqe pyjore për instalim antenash, si dhe nuk dokumentohet shlyerja e detyrimeve nga operatori xx, nuk dokumentohen, pasqyrohen as raportohen në marrjen në dorëzim pjesa e të drejtave dhe detyrimeve të kontratave, gjendje kjo në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 433, datë 08.6.2.2016“ ‘Për Transferimin në Pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas Listave të Inventarit, dhe aktualisht në Administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, ku shprehet se; “*Të drejtat dhe detyrimet e personave fizik/juridik të fituara me kontratat ekzistuese për marrjen në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kullor vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas parashikimeve kontratore dhe legjislacionit në fuqi*” urdhrit nr. 4632, datë 18.7.2016 ”Mbi Dorëzimin e pyjeve dhe kullotave në Bashki” të Ministrit të Mjedisit. Këto mosveprime kanë sjellë si pasoje dëmin ekonomik në vlerën **3,309,367 lekë** ndarë përkatësisht: vlera 140,079 lekë nga llogaritja e mos përfshirja 1vit të vlerës tarifës re për periudhën nga koha e daljes së VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, që ka sjellë dëmin ekonomik prej 140,079 lekë, 503,008 lekë nga përdorimi pa kontratë i sipërfaqeve dhe 2,666,280 lekë nga mos justifikimi me dokumente bankare te hyra në bashki të qerasë së pretenduar si e paguar, ndaj xx Tiranë, në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime ne VKM nr.391, datë 21.06.2006 °Për Përcaktimin e Tarifave në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Kontratat e Lidhura nga ish-DSHP dhe ish-Komunat, transferuar në Bashki për Antena të telefonisë celulare dhe në proces lidhje kontrate Bashkia Shkodër” (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 116-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa të arkëtojë në vlerën prej **3,309,367 lekë** qira e papaguar për 4 vjet 2013-2016 ndaj xx, ndarë: 140,079 lekë nga llogaritja e mos përfshirja 1vit të vlerës tarifës re për periudhën nga koha e daljes së VKM nr.1064, datë 22.12.2010, 503,008 lekë nga përdorimi pa kontratë i sipërfaqeve dhe 2,666,280 lekë nga mos justifikimi me dokumente bankare te hyra në bashki të qerasë së pretenduar si e paguar, ndaj xx Tiranë si dhe të rishqyrtojë, saktësojë, eliminojë mangësitë në dokumentacione, pasaktësitë e parregullsitë në përmbajtje, si dhe të përditësojë me aktet e reja nënligjore dhe të rishkruajë 3 kontratat me **Operatorin xx**, sipas tabelës emërtuar “Kontratat e Lidhura nga ish-DSHP dhe ish-Komunat, transferuar në Bashki për Antena të telefonisë celulare dhe në proces lidhje kontrate Bashkia Shkodër”.

Menjëherë

CI. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, me kontratën nr. 6325/9, datë 14.06.2016, lidhur me subjektin xxxxxxxx ka kontraktuar investimin “*Shërbimi pastrimit të mbetjeve urbane,*

Njësia administrative Velipojë”, për vlerën 11,389,518 lekë me tvsh me afat përfundimi deri në datë 10.09.2016 për (89 ditë kalendarike) dhe e likuiduar në masën 100%. Kontrata është lidhur 20 % mbi kontratën bazë, por pa zbatuar afatet kohore pasi kontrata bazë rezulton e lidhur për 36 muaj, ndërsa shtesë kontrata për 3 muaj, kur afati i shërbimit shtesë duhet të ishte 7.2 muaj (36muaj x 20%) ose deri më datë 20.12.2016.

Referuar parashikimit të nenit 4 të Kushteve të kontratës bazë dhe duke vlerësuar faktin se, subjekti xxxxxx është likuiduar me shumën 9,758,551 lekë për afatin 4.33 muaj, rezulton se vlerë e përfituar nga subjekti duhej të ishte likuiduar deri në datën 20.12.2016.

Nga mos zbatimi i kushteve të kontratës dhe mos prokurimi i shërbimit, si dhe referuar në shpjegimet paraqitura nga NJP, personi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, por dhe materialeve mbështetëse të dërguara me Projektraportin e Auditimit, subjekti “Leka 2007”, ka vazhduar të kryej shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane deri në fund të vitit 2016.

Likuidimi në formën e pagesës paradhënie, pa procedura prokurimi për këtë shërbim, i ka shkaktuar buxhetit të bashkisë mospërdorim me *efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet* të fondeve publike në vlerën **9,758,551 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 54-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Bashkia Shkodër, të analizoj e nxjerr përgjegjësinë për shpenzimet lidhur me kontratën e shërbimit të pastrimit nr. 6325/9, datë 14.06.2016, lidhur me xxxxx, lidhur deri më 10.09.2016 dhe vazhduar edhe në vitin 2017, duke marrë masa që të mos përsëritet një situatë e tillë në të ardhmen.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, ka kryer shpenzime me blerje të vogla ne shkelje të disiplinës financiare jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat për 3 raste në vlerën prej **60,938 lekë**, kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje dhe pajisje ambiente zyresh (urdhër shpenzimeve nr. 133 datë 19.03.2014; nr. 136 datë 19.03.2014 dhe nr. 620 datë 28.10.2014), ku komisioni i blerjeve me vlera të vogla ka s’kualifikuar dhe nuk ka zgjedhur drejt ofertat, në kundërshtim me pikën 1/c kreu II të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, të ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Bashkia Shkodër, të analizoj e nxjerr përgjegjësinë për shpenzimet me blerje të vogla jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje ambientesh dhe pajisje zyresh në vlerën prej **60,938 lekë**, si dhe të evidentoj përgjegjësinë e anëtarëve të Komisionit me blerje të vogla.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Dajç, janë konstatuar **21 raste pagesash** të kryera me bankën, për blerjet me vlera të vogla, për mallra dhe shërbime, të cilat janë kryer me shkelje procedurash, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin 131/112 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, si dhe Udhëzimit nr. 7, datë 20.12.2012, “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin elektronik” (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 147-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi: Bashkia Shkodër, Sektori i Auditimit të Brendshëm të kryejnë një mision auditimi në ish komunën (NJA) Dajç për periudhën 01.01.2013 deri më datën 30.06.2015, lidhur me ligjshmërinë e kryerjes të pagesave nëpërmjet veprimeve të bankës, përfshirë edhe 21 raste pagesash të konstatuara nga KLSH, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë ndaj personave përkatës.

Menjëherë

CIL. TË ARDHURA TË MUNGUARA NGA MOSVËNIA NË EFICENCE E ASETËVE, KULLOTA TË ISH-KOMUNAVE.

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër për vitin 2016 dhe 5 ish-Komunat (aktualisht Njësi Administrative) Postrib, Pult, Shal, Shosh dhe Guri i Zi, për sipërfaqen e fondit kullësor prej 5377 ha, e ndarë sipas strukturës së shtrirjes, nuk kanë hartuar e zbatuar asnjë plan menaxhimi e mbarështimi në kullota e livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash, si dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve. Mosveprimi ka sjellë mungesë të ardhurash të munguara dhe nëse do të procedohej me dhënien në përdorim të këtyre sipërfaqeve, do të rriteshin të ardhurat për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vlerën **129,048 mijë lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 113-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Bashkia Shkodër, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, të marrin masa për vënien në efikasitet të sipërfaqes së fondit kullësor prej 5377 ha, ndodhur në territoret e 5 ish-Komunave, të hartojë planet e menaxhimit dhe mbarështimit, si dhe të analizojnë vlerën e të ardhura të munguara prej 129,048 mijë lekë.

Menjherë dhe në vazhdimësi

D. MASA DISIPLINORE:

D/I. PËR PUNONJËSIT QË JANË PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër, që ti kërkoj Komisionit Disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, e parashikuar në nenin 58, germa “c”, për 12 punonjësit e mëposhtëm:

1. **xxxxxxx**, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike, për periudhën 2014-2016;

2. **xxxxxxx**, me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike për periudhën 2014-2016;

3. **xxxxxx**, me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike për periudhën 2014-2016;

-Për mangësi të organizimit të punës të Drejtorisë së Shërbimeve Publike si në përcaktimin e saktë të analizave përkatëse dhe zërave të punës dhe shërbimeve publike të pastrim-gjelbërimit dhe lidhjen e kontratës themelore dhe kontratave vjetore dhe për pasojë edhe të pagesave të kryera për to.

-Për përpjesëtimin në mënyrë të njëtrajtshme të volumeve të punës dhe vlerës së kontratës në 12 muajt e vitit dhe paraqitjen në situacionet mujore të shërbimeve të pastrim gjelbërimit dhe jo sipas faktit konkret dhe stinës dhe për pasojë edhe të pagesave të kryera për to.

-Për pagesat e punëtorëve në ditët me shi, duke qenë se në fakt në ditët me shi është e pamundur të kryhen disa procese pune dhe shërbime të pastrim-gjelbërimit, (fshirja e rrugëve, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta, etj. pavarësisht nga rrobat e punës.) pagesat e punëtorëve duhen të kryhen me pagën minimale të punonjësve të miratuar dhe deklaruar në tatime dhe sigurime shoqërore) dhe jo me normë dhe volume pune sikurse keni vepruar në rastin konkret.

-Për pagesat e punëtorëve për mirëmbajtje 30% e rrugëve dhe për prodhim fidanë lule sezonale konsiderohen të pa argumentuara pasi këto pagesa të paraqitura në zëra pune si të veçantë janë përfshirë indirekt në zëra të tjerë të situacioneve të firmave sipërmarrëse, cilësuar më hollësisht në proces- verbalin nr.15 datë 28.07.2017

4. xxxxxxxx në cilësinë e Drejtorit të Ardhurave Vendore;

-Për mos planifikim dhe mos realizim të të ardhurave nga toka bujqësore me pretendimin se “në këtë Bashki nuk janë regjistruar si prona dhe nuk është marrë certifikata e pronësisë nga ZVRPP”, në kundërshtim me nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

-Për mos plotësimin e dosjeve të subjekteve me dokumentacionin ligjor, në mos zbatim të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 12 “Taksa mbi tokën bujqësore”, si dhe nenit 12 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006

-Nuk është krijuar regjistri i plotë për evidentimin e taksës mbi tokën bujqësore dhe taksën për ndërtesën, si dhe nuk janë marrë të dhënat e nevojshme nga Njësitë Administrative (ish komuna) dhe nga ZVRPP Shkodër për pronësinë mbi tokën bujqësore dhe ndërtesat.

- Nuk kanë kontrolluar respektimin e kushteve të kontratës për tokat bujqësore të pandara, duke mos realizuar plotësisht dhe në afatet e përcaktuara pagesën e qirasë, nuk janë ushtruar kontrole periodike mbi gjendjen fondit të tokës bujqësore të marrë me qira mbi bazën e kartelës personale për çdo kontratë, përdorimin e saj sipas destinacionit të përcaktuar, për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e tokës, veprime në kundërshtim me kërkesat e UKM nr. 3 datë 16.05.2007, dhe UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për tokat bujqësore të pandara”, nenet 8, 9 dhe 10 dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”.

5. xxxxxxxx me detyrë ish Drejtore urbanistike deri Korrik 2015, Aktualisht Drejtore Drejtorisë Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të ujërave,

Për keq menaxhimin e pyjeve e kullotave kontratave për periudhën v.2016 ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, të ndryshuar me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

Për shkelje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, dhe me nenin 52, pika a,b,c të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” në dhënien e lejeve të përdorimit në mos respektim të afateve të Lejes ndërtimit.

6. xxxxxxxx, me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Studimit, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve (për PPV), për mangësitë në hartimin e PPV

7. xxxxxxxx me detyrë Drejtor i Kontrollit, Zhvillimit të Territorit prej Korrikut 2016, për mangësitë e menaxhimit të IMTV 2014-2016

8 xxxxxxxx , me detyrë Përgjegjës Sektori Lejeve Ndërtimit Kontrollit Territorit,

9. xxxxxxxx, me detyrë përgjegjëse Arkivit të Urbanistikës

Për shkelje të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, dhe me nenin 52, pika a,b,c të ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” në dhënien e lejeve të përdorimit në mos respektim të afateve të Lejes ndërtimit bazuar në ligjin ngarkohen me përgjegjësi:

10. xxxxxxxx, me detyrë specialist inxhinier Pyje,

11. xxxxxxxx , me detyrë teknik Pyjesh,

Për keq menaxhimin e pyjeve e kullotave kontratave për periudhën v.2016 ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, të ndryshuar me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

12. xxxxxxxx, ish-specialist, për keq menaxhim të aseteve në ish-Komunën Postribë aktualisht specialist i Bashkisë Shkodër.

D/2. PËR PUNONJËSIT QË MARRËDHËNIET E PUNËS RREGULLOHEN SIPAS KODIT PUNËS.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 9, 10 të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave nga “Vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, **për 3 punonjësit** e mëposhtëm:

1. **xxxxxxx** me detyrë administrator i NJA Gur i Zi, prej v.2015
2. **xxxxxxi**, me detyrë administrator i NJA Ana e Malit prej v.2015
3. **xxxxxxx**, me detyrë administrator i NJA Postribë prej v.2015

Për shkeljet më menaxhimin dhe administrimin e aseteve, ligjin nr. 9228, datë 29.04. 2004, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

D/III. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR NGA DETYRA DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL:

Për 53 ish punonjësit e tjerë të përmendur me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, Masa Disiplinore për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Bashkinë Shkodër dhe ish-Komunat **Shalë, Pult, Shosh, Postribë, Rrethina, Gur i zi, Bërdicë, Ana malit, Dajç, Velipojë**, nuk mund të ezaurohen, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk kanë adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim mase.

Shënim: Për punonjësit të cilat aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Shkodër, dhe Njësitë Administrative **Shalë, Pult, Shosh, Postribë, Rrethina, Guri i Zi, Bërdicë, Ana e Malit, Dajç dhe Velipojë**, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk propozojmë për masa disiplinore, për arsye se gjatë përmbushjes së detyrave, nuk kanë sjellë pasojë të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

F. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, dhe në fushën e mbikëqyrjes të pastrim gjelbërimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Shkodër t’i **kërkoj Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë, për 4 mbikëqyrës punimesh, dhe për 3 mbikëqyrës shërbimesh** si më poshtë:

F. 1. Për 4 Mbikëqyrës punimesh ndërtimi

1. xxxxxx në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën **4,442,862 lekë pa tvsh nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve** në objektet:

a. “*Blloku i pallateve Vau i Dejës*”, me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 4,442,862 lekë pa tvsh; (*Trajtuar më hollësisht në faqet 98 -123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2. xxxxxxxj në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën **6,153,448 lekë pa tvsh** nga të cilat:

➤ *Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve* në objektet:

a. “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2016*”, (pjesa takuese) me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **166,221 lekë pa tvsh**;

b. “*Rikonstruksion linja e ndriçimit rruga Gjovalin Gjadri*” sh.p.k, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **189,363 lekë pa tvsh**;

➤ *Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve*

a. “*Blloku i pallateve Vau i Dejës*”, me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **4,442,862 lekë pa tvsh**;

b. “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i III-të*”, me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,355,002 lekë pa tvsh**; (*Trajtuar më hollësisht në faqet 98-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. xxxxxxi në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën **340,381 lekë pa tvsh**:

➤ *Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve* në objektet:

a. “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2014*”, me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **106,400 lekë pa tvsh**;

b. “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2015*”, me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **67,760 lekë pa tvsh**;

c. “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2016*” (pjesa takuese) me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **166,221 lekë pa tvsh**;

4. *E N* në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara me pasojë dëm ekonomik në vlerën **3,641,456 lekë pa tvsh** nga të cilat:

➤ *Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve* në objektet:

a. “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i III-të*”, me sipërmarrës punimesh xxxxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,355,002 lekë pa tvsh**;

b. “Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i IV-të”, me sipërmarrës punimesh xxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,829,238 lekë pa tvsh**;

➤ *Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve*

a. “Zbatim rikualifikim Urban Blloqe Banimi Qemal Draçini (pallati me Hark)”, me sipërmarrës punimesh xxxxxx, për diferencat për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **457,216 lekë pa tvsh** (Trajtuar më hollësisht në faqet 98 -123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

G. MBI DISA NDRYSHIME NDËRMJET PROJEKTRAPORTIT DHE RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT.

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 491/5 prot., datë 04.08.2017 ka dërguar në Bashkinë Shkodër projektraportin e auditimit, në të cilin janë pasqyruar gjetjet dhe rekomandimet sipas problematikës së evidentuar nga grupi i auditimit. Pas marrjes së komenteve dhe shpjegimeve nga subjekti i audituar, bazuar në Rregulloren e Brendshme nr. 107, miratuar më datë 08.08.2017 “Për procedurat e auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, neni 35-Kontrolli i Cilësisë për Raportin Përfundimtar, për të siguruar cilësinë e këtij auditimi, Departamenti Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë, Drejtori dhe Kryeaudituesi i Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtori i Përgjithshëm, rishikoi në tërësi Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Shkodër. Në përfundim të vlerësimit të objektivitetit të auditimit, u arrit në konkluzionin se shumata e llogaritura si e ardhur e munguar nga mos vjelja e qerasë nga objektet publike të cilat janë zënë në mënyrë të paligjshme prej qytetarëve, është jo e saktë, për sa kohë që vendosja e një detyrimi të tillë mund të krijojë premisa për të ligjësuar një marrëdhënie që ka në bazë paligjshmërinë.

Për përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve në raport me gjetjet dhe konstatimet, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi u propozua që disa rekomandime të klasifikuara si Shpërblim Dëmi, të kalojnë në rubrikën e Masa Organizative. Kështu, si pasojë e këtyre rivlerësimeve, rekomandimet për masa Shpërblim Dëmi nga vlera prej **169,240,556 lekë** të pasqyruara në projektraportin e auditimit, në raportin përfundimtar të auditimit bie në vlerën **12,638,792 lekë**, ndërsa vlera prej **156,601,774 lekë** ka kaluar në rubrikën Masa Organizative e detajuar si më poshtë:

- **Vlera 81,176,929 lekë**, e cila lidhet me objektet pronë publike të zaptuara forcërisht nga persona të ndryshëm, janë kaluar në Rubrikën Masa organizative nr. 23 , duke i rekomanduar Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Organet e Rendit, marrjen e masave për çlirimin nga zaptimi i jashtëligjshëm dhe vënien në funksion sipas destinacionit të këtyre objekteve publike (Trajtuar më hollësisht në faqen 124- 127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- **Vlera 44,988,000 lekë**, për vendimet e gjobave të Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Shkodër, për mos pagimin në afat nga kundërvajtësit, nuk ka aplikuar kamatëvonesa shuma cilat në projektraportin e auditimit kanë qenë tek rubrika Masa Shpërblim dëmi, janë kaluar në Rubrikën masa organizative nr. 25, duke i rekomanduar Bashkisë Shkodër që pasi të vendoset dhe vlera e kamat-vonesave për gjobat e tjera të cilat nuk kanë kaluar në proces gjyqësor të vazhdojë ndjekjen deri në arkëtimin e vlerës plotë të tyre. (Trajtuar më hollësisht në faqen 131- 134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

- **Vlera 10,611,720 lekë**, kaluar në masa organizative, kjo lidhur me objektin “Kinema Milenium”, miratuar në listën e pronave për Bashkinë Shkodër, ndërkohë që për këtë objekt disponohet kontrata e datës 24.03.2000, lidhur ndërmjet ish-Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe xxxxxx, kontratë e cila është rekomanduar për t’u verifikuar paraprakisht nga ana e Auditit të Brendshëm Publik të Bashkisë Shkodër (Trajtuar më hollësisht në faqen 123-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

- **Vlera 7,200,000 lekë**, lidhur me objektet pronë publike të zaptuara forcërisht nga persona të ndryshëm, në ish Komunën Ana e Malit janë kaluar në rubrikën Masa organizative nr. 24,

duke i rekomanduar Bashkisë Shkodër marrjen e masave në bashkëpunim me Organet e Rendit, për lirimin nga zaptimi i jashtëligjshëm dhe vënien në funksion të objekteve publike sipas destinacionit *(Trajtuar më hollësisht në faqen 127-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- **Vlera 6,354,000 lekë**, kaluar në masë organizative nr. 22, e cila trajton objektet pronë publike (3 kopshte) të zaptuara forcërisht nga qytetar të ndryshëm, kanë kaluar në masa organizative, duke i rekomanduar Bashkisë Shkodër marrjen e masave në bashkëpunim me Organet e Rendit për lirimin nga zaptimi i jashtëligjshëm dhe vënien në funksion të objekteve. Kjo edhe për shkak se marrëdhëniet detyruese lindin, në se nuk ka një kontratë midis palëve, prandaj në raportin përfundimtar të auditimit mbeten e shifrat sikundër trajtuar në projekraportin e auditimit me argumentin nëse do të kishte një kontratë qiraje të ardhurat e bashkisë do të rriteshin me atë vlerë të llogaritur *(Trajtuar më hollësisht në faqen 122- 123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- **Vlera 2,971,125 lekë** që ka lidhje me pagesat e shërbimit për *pastrimin mekanik dhe manual në ditët me shi, si dhe prodhimi i luleve si një zë i veçantë i kontratës së mirëmbajtjes së luleve*, ka kaluar në masa organizative me nr. 7, sipas vlerësimit të Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve *(Trajtuar më hollësisht në faqen 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- **Vlera 1,400,000 lekë**, për gjocat e pavendosura për mos ndjekjen e afateve të lejeve të ndërtimit, janë vlerësuar të ardhura të munguara, kaluar në masë organizative nr.15 *(Trajtuar më hollësisht në faqen 108-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

- **Vlera 1,900,000 lekë**, për gjocat e pavendosura për mos ndjekjen e afateve të lejeve të përdorimit, janë vlerësuar të ardhura të munguara, kaluar në masë organizative nr. 16 *(Trajtuar më hollësisht në faqen 110-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Gjithashtu janë bërë ndryshime nga projekraporti në raportin përfundimtar të auditimit dhe në rekomandimet tek Rubrika “Masa organizative” dhe për “Mosefektivitete të fondeve” për prokurimet publike.

Në projektraportin e auditimit në kapitullin Masa Organizative është trajtuar edhe vlera **391,677,434 lekë**, shumë e cila pas kontrollit të cilësisë nga Departamenti Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, sipas procedurës së Rregullores së Brendshme nr.107, datë 08.08.2017 “Për procedurat e auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshoi pasi është hequr shuma prej **129,048,000 lekë** *(trajtuar në pikën CII/1)*. Kjo shumë (129,048 mijë lekë) konsiderohet si e ardhur e munguar nga mosvënia në efikasitet të aseteve, kullotave të ish komunave.

H .TË TJERA:

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit këtë auditim e vlerëson dobët, pasi puna e bërë nga grupi i auditimit konsiderohet e paplotë në drejtim të auditimit të shpenzimeve të prokurimeve, mbledhjes së taksave vendore dhe klasifikimit të shkeljeve (gjetjeve) të konstatuara në auditimin e aseteve.

Vonesa në evadimin e këtij auditimi ka ardhur për shkak të madhësisë së subjektit të audituar, (Bashkia Shkodër dhe 10 ish komuna); periudhë tre vjeçare e auditimit, si dhe nga problematika komplekse. Gjithashtu, përgjegjësi i grupit edhe anëtarët e tjerë të grupit të auditimit në të njëjtën kohë ka qenë të angazhuar edhe me auditime të tjera. Të gjithë këta faktorë përfshi dhe shqyrtimin nga Drejtuesit e Departamenteve dhe Drejtorin e Përgjithshëm, Departamentin Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, Cilësisë, si dhe diskutimin e klasifikimeve për administrimin e aseteve duke mos rënduar me të padrejtë qytetarë të shumë në numër për problemin e banimit për një kohë të gjatë në objekte publike.

Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes së Qeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës të analizojnë Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe të diskutohen problematikat e këtij auditimi me audituesit e Departamentit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ